

# KARAKTERISTIKAT E MJETEVE RRUGORE

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

## Metadate Referenciale

1. Kontakt .....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore .....	2
4. Njësia matëse .....	4
5. Periudha e referencës .....	4
6. Mandati institucional .....	4
7. Konfidencialiteti .....	5
8. Politika e botimit .....	6
9. Shpërndarja e shpërndarjes .....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	6
11. Manaxhimi i cilësisë .....	7
12. Rëndësia .....	8
13. Saktësia dhe besueshmëria .....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	9
15. Kohësorja dhe Krahësueshmëria .....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	9
17. Rishikimi i të dhënave .....	9
18. Përpunimi statistikor .....	10
19. Komente .....	10
Aneks .....	10

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të R&D, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit, Drejtoria e Statistikave Ekonomike
1.3. Personi i kontaktit	Irsida Nuellari
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës, Sektori i Statistikave të R&D, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, Kodi Postar 1017, Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:inuellari@instat.gov.al">inuellari@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	14.10.2022
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	14.10.2022
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	14.10.2022
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Statistikat mbi “Karakteristikat e mjeteve rrugore” japin informacion mbi numrin e mjeteve rrugore që qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë, të regjistruar me status “aktiv” ose “të çregjistruara përkohësisht” në Regjistrin Kombëtar Shqiptar të mjeteve rrugore. Në këtë publikim paraqiten disa tregues mbi mjetet rrugore, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i mjeteve sipas llojit</li> <li>• Mjetet rrugore sipas qarqeve</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mjete rrugore sipas kambios</li> <li>• Mjete rrugore sipas vitit të prodhimit</li> <li>• Mjete rrugore sipas markës</li> <li>• Autovetura sipas markës dhe viteve të prodhimit</li> <li>• Mjetet rrugore sipas lëndës djegëse</li> <li>• Autovetura sipas vëllimit të motorrit</li> </ul> <p>Publikimi “Karakteristikat e mjeteve rrugore” përfshin të dhëna të detajuara lidhur me mjetet rrugore gjithsej sipas qarqeve si dhe një paraqitje krahasimore me mjetet rrugore deri në vitin 2019 sipas detajimeve përkatëse tësi: mjetet rrugore gjithsej, autovetura sipas viteve të prodhimit, autovetura sipas lëndës djegëse dhe autoveturat sipas vëllimit motorrik, autobusë dhe kamionë sipas qarqeve, autobusë dhe kamionë sipas llojit të kambios, sipas moshës, sipas markës, autobusë sipas lëndës djegëse dhe sipas vëllimit motorrik.</p>
3.2.Sistemi i klasifikimit	Të dhënat dhe përkufizimet e përdorura janë në përputhje me Kodin Rrugor.
3.3. Mbulimi i sektorit	Informacioni statistikor mbulon të dhënat për mjetet e transportit rrugor, që rezultojnë aktive ose të çrregjistruara përkohësisht në Republikën e Shqipërisë.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p><b>Inventari i mjeteve rrugore</b> – Numri i mjeteve rrugore të regjistruara në një datë specifike në vend dhe licensuar për të përdorur rrugët me trafik publik.</p> <p><b>Automjete për transport të përzier (ATP)</b> - përfshihen mjetet që kanë një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjësë, duke përfshirë dhe ndenjësën e drejtuesit të mjetit.</p> <p><b>Automjete për përdorim të veçantë (APV)</b> - mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të vecantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe i materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.</p> <p><b>Automjete për transport të veçantë (ATV)</b> - mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të vecanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përbashkët, me mekanizma special që i shërbejnë këtij qëllimi.</p> <p><b>Kamion</b> - mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave</p> <p><b>CC-</b> njësia matëse e vëllimit motorrik të mjeteve rrugore e shprehur në centimetra në kub.</p> <p><b>Autoveturë</b> - mjet motorrik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh, në të cilin numri i vendeve të uljes (duke përfshirë edhe shoferin) nuk e kalon numrin 9.</p>

	<p><b>Autobus</b> - mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh me numrin e vendeve të uljes (duke përfshirë dhe vendin e shoferit) me më shumë se 9 vende.</p> <p><b>Ciklomotor</b> - mjet me motor, me dy, tre ose katër rrota.</p> <p><b>Gjysëm rimorkio</b> - mjet motorik i transportit i destinuar për transport pasagjerësh dhe mallrash.</p> <p><b>Makinë bujqësore</b> - mjet motorik me rrota ose me zinxhir i destinuar për t'u përdorur në bujqësi e pylltari, për transport të mallrave bujqësore.</p> <p><b>Motokarro</b> - mjete me tri rrota, të destinuar për transport malli. Mund të kenë deri në dy ndenjësë për njerëzit që merren me transportin, duke përfshirë edhe drejtuesin e mjetit.</p> <p><b>Tërheqës</b>- Mjet i destinuar vetëm për tërheqjen e rimorkiove ose gjysmërimorkiove.</p>
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore i referohet mjetit rrugorë të licensuar për të përdorur rrugët me trafik publik.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore përfshin të gjitha mjetet rrugore që rezultojnë aktive ose të çrregjistruara përkohësisht në Republikën e Shqipërisë.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat mbi statistikën e "Karakteristikave të mjeteve rrugore" mbulojnë të gjithë territorin e vendit.
3.8. Mbulimi në kohë	Statistikat mbi "Karakteristikave të mjeteve rrugore" janë publikuar për herë të parë për vitin referencë 2019. Periudha referuese e të dhënave për publikimin "Karakteristikave të mjeteve rrugore" është viti 2021.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	Të dhënat mbi "Karakteristikave të mjeteve rrugore" publikohen në vlera absolute dhe përqindje.
5. Periudha e referencës	Periudha referuese e të dhënave për publikimin "Karakteristikave të mjeteve rrugore" është vjetore. Ky raport i përket vitit referencë 2021.
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>➤ Baza ligjore për prodhimin e treguesve për "Karakteristikave të mjeteve rrugore" janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligjin Nr. 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare";</a></li> <li>• <a href="#">Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare, 2017-2021;</a></li> <li>• <a href="#">Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë;</a></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Sipas rregulloreve përkatëse të BE-së: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullorja e e Parlamentit dhe Këshillit Evropian <a href="#">Nr. 70/2012, datë 18 Janar 2012</a> “Mbi kthimet statistikore në lidhje me transportin e mallrave me rrugë”.</li> </ul> </li> </ul>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Disa tregues të statistikave mbi “Karakteristikat e mjeteve rrugore” transmetohen në EUROSTAT prej vitit 2016.
<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura nga ndërmarrjet konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njërive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njërive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijojnë paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime</p>

	shkencore.
<b>8. Politika e botimit</b>	
8.1. Kalendarin e publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve	<a href="#">Kalendarin e Publikimeve</a> është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesin e përdoruesve	Në përputhje me nenin 34, të Ligjit Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit mujor "Karakteristikave të mjeteve rrugore" janë si më poshtë: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Website – publikim online;</li> <li>2. Kërkesat e shkruara (me postë ose <a href="#">email</a>);</li> <li>3. Seksioni <a href="#">Kërkesa të dhënash</a>, për përdoruesit e jashtëm.</li> </ol>
<b>9. Shpeshësia e shpërndarjes</b>	Publikimi "Karakteristikave të mjeteve rrugore" shpërndahen në bazë vjetore.
<b>10. Aksesin në të dhëna dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të karakteristikave të mjeteve rrugore: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i mjeteve sipas llojit</li> <li>• Mjetet rrugore sipas qarqeve</li> <li>• Mjete rrugore sipas kambios</li> <li>• Mjete rrugore sipas vitit të prodhimit</li> <li>• Mjete rrugore sipas markës</li> <li>• Autovetura sipas markës dhe viteve të prodhimit</li> <li>• Mjetet rrugore sipas lëndës djegëse</li> <li>• Autovetura sipas vëllimit të motorit</li> </ul> Njoftimi për shtyp për "Karakteristikave të mjeteve rrugore" publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Të dhënat për publikimin "Karakteristikave të mjeteve rrugore" gjenden në faqen e internetit të INSTAT në temën Transporti: <a href="#">Karakteristikave të mjeteve rrugore</a> .

10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Të dhënat e publikimit "Karakteristikat e mjeteve rrugore" janë të vendosura në databazën statistikore, por të dhëna të detajuara mund të gjenden në format Excel ku treguesit kryesorë jepen të detajuar. Këto tabela mund të gjenden në linkun: <a href="#">Databaza Statistikore</a> .
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Këto të dhëna i jepen përdoruesve në rast se nuk janë konfidenciale bazuar në nenin 31, Ligji Nr. 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për kontaktet në linku më poshtë: <a href="#">Kërkesë të dhënash formulari</a> .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacion shtesë mbështetës u ofrohet çdo përdoruesi në fund të publikimit. Në faqen e INSTAT, ndodhet një seksion lidhur me metodologjinë e përdorur mbi statistikave të "Karakteristikave të mjeteve rrugore", i cili mund të gjendet në link-un: <a href="#">Metodologji Transporti</a> .
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të R&D, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat mbi statistikave të "Karakteristikave të mjeteve rrugore" për qëllime të brendshme.
<b>11. Manaxhimi i cilësisë</b>	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat mbi "Karakteristikat e mjeteve rrugore" krahasohen të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të

	Transportit Rrugor për rakordimin e të dhënave vjetore.
<b>12. Rëndësia</b>	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e të dhënave të “Karakteristikave të mjeteve rrugore” janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Përdoruesit e jashtëm: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucione të administratës publike</li> <li>• Universitete</li> <li>• Organizata jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare</li> <li>• Biznese</li> <li>• Kërkuar shkencorë, studentë dhe grupe të tjera të ngjashme.</li> </ul> </li> </ul>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me "Karakteristikat e mjeteve rrugore" për vitin 2021 janë rreth 21.415 klikime.</p> <p>Gjatë vitit 2021 INSTAT ka kryer vërtetimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vërtetimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës "Karakteristikat e mjeteve rrugore" është vlerësuar me 3.57 (71.4%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) deri në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit <a href="#">Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</a>.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave të "Karakteristikave të mjeteve rrugore" për vitin 2021 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar nga INSTAT nga ato të kërkuara nga rregulloret e ndjekura. Të dhënat janë në përputhje në masën 85 %.</p>
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Të dhënat mbi “Karakteristikat e mjeteve rrugore” mblidhen në mënyrë administrative në zbatim të bazës ligjore dhe Memorandumit të Mirëkuptimit midis INSTAT dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR). Nuk kryhen vërtetime për mjetet e transportit rrugor në Shqipëri.</p>
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Nuk aplikohet pasi është burim administrativ.</p>
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues</p>



	për përdoruesit.								
<b>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</b>									
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e statistikave të “Karakteristikave të mjeteve rrugore” janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 287 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T+ 287 ditë). Periudha referuese e rezultateve të statistikave të “Karakteristikave të mjeteve rrugore” është 31 Dhjetori 2021.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>10/14/2022</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>287</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2021	Data e publikimit	10/14/2022	Afatet kohore	287		
Periudha referuese	12/31/2021								
Data e publikimit	10/14/2022								
Afatet kohore	287								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat e “Karakteristikave të mjeteve rrugore”, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i “Karakteristikave të mjeteve rrugore” ka qenë i përpiktë në kohë në masën 100 %.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>10/14/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>10/14/2022</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2021	Data e shpallur	10/14/2022	Data e publikimit	10/14/2022	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2021								
Data e shpallur	10/14/2022								
Data e publikimit	10/14/2022								
Vonesa në kohë	0								
<b>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</b>									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat e "Karakteristikave të mjeteve rrugore" mbulojnë të gjithë territorin e vendit. Rezultatet që INSTAT prodhon janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e EUROSTAT në nivel kombëtar dhe qarku.								
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Informacioni statistikor grumbullohet në frekuencë vjetore që prej vitit 2018, duke siguruar një krahasueshmëri prej 4 vjetësh, (CC2 = Jlast-Jfirst + 1 = 4).</p> <p>Duke filluar nga viti 2020 janë shtuar dy tregues të rinj, mjete rrugore sipas qarqeve dhe mjete rrugore sipas llojit të kambios. Gjithashtu, janë shtuar edhe detajime për treguesit ekzistues.</p>								
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.								
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohet përpara se të finalizohet. Kontrollohen lidhjet ndërmjet variablave dhe konfirmohet koherenca midis serive të brendshme të të dhënave të ndryshme.								
<b>16. Kostoja dhe ngarkesa</b>	Stafi i dedikuar për statistikave të “Karakteristikave të mjeteve rrugore” në Sektorin e Statistikave të R&D, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit është: 1 punonjës.								
<b>17. Rishikimi i të dhënave</b>									

17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të statistikave në lidhje me “Karakteristikat e mjeteve rrugore” hartohen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë, referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e Revizionimit Statistikor</a></li> <li>• <a href="#">Politika e Trajtimit të Gabimeve</a></li> </ul>
17.2. Praktika e rishikimit	Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi "Karakteristikat e mjeteve rrugore" për vitin 2021, subjekt i këtij raporti.
<b>18. Përpunimi statistikor</b>	
18.1. Burimi i të dhënave	Burimi i vetëm i të dhënave të “Karakteristikave të mjeteve rrugore” është burimi administrativ. Të dhënat grumbullohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Mbulimi i të dhënave është në nivel vendi dhe qarku, dhe informacioni statistikor mundësohet në kohë.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen me bazë vjetore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat e publikimit "Karakteristikat e mjeteve rrugore" janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor grumbullohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave të publikimit "Karakteristikat e mjeteve rrugore" u kryhen kontrole logjike dhe matematikore. Këto kontrole realizohen për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon, gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
<b>19. Komentë</b>	
<b>Aneks</b>	